

LIGJ
Nr. 72/2018

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN 2005 TË
KONVENTËS PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË
LUNDRIMIT DETAR, ADERUAR ME LIGJIN NR. 8850/2001, DHE PROTOKOLLIN
2005 TË PROTOKOLLIT PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR
SIGURISË SË PLATFORMAVE FIKSE NË SHELFIN KONTINENTAL, ADERUAR ME
LIGJIN NR. 8850/2001**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, dhe Protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.10.2018

Shpallur me dekretin nr. 10940, datë 9.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

PROTOKOLLI I 2005 I KONVENTËS
PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË LUNDRIMIT
DETAR

HYRJE

Shtetet Palë të këtij Protokolli,

duke qenë palë të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, bërë në Romë më 10 mars 1988;

duke pranuar se aktet terroriste kërcënojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare;

duke pasur parasysh për Rezolutën A.924 (22) të Asamblesë së Organizatës Ndërkombëtare Detare që kërkon rishikimin e masave ekzistuese ndërkombëtare ligjore dhe teknike dhe shqyrtimin e masave të reja, me qëllim parandalimin dhe ndalimin e terrorizmit kundër anijeve dhe përmirësimin e sigurisë në bord dhe në breg dhe, në këtë mënyrë për të ulur rrezikun për pasagjerët, ekuipazhet dhe personelin e portit në bordin e anijeve dhe në zonat e porteve dhe anijet dhe ngarkesat e tyre;

të ndëryjegjëshëm për Deklaratën mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar, bashkëlidhur Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 49/60, të datës 9 dhjetor 1994, në të cilën, ndër të tjera, Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara solemnisht rikonfirmojnë dënimin e tyre të prerë për të gjitha veprimet, metodat dhe praktikatat e terrorizmit si kriminale dhe të pajustificueshme, kudo dhe nga kushdo që i ka kryer, përfshirë ato që rrezikojnë marrëdhëniet miqësore midis shteteve dhe

popujve dhe që kërcënojnë integritetin territorial dhe sigurinë e shteteve;

duke vërejtur Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 51/210, të datës 17 dhjetor 1996, dhe Deklaratën për Plotësimin e Deklaratës së vitit 1994 mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar, bashkëlidhur këtij Protokoll;

duke rikujtuar rezolutat 1368 (2001) dhe 1373 (2001) të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, të cilat pasqyrojnë vullnetin ndërkombëtar për të luftuar terrorizmin në të gjitha format dhe manifestimet e tij dhe që u ka caktuar detyra dhe përgjegjësi shteteve dhe, duke marrë parasysh kërcënimin e vazhdueshëm nga sulmet terroriste;

duke rikujtuar, gjithashtu, Rezolutën 1540 (2004) të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, e cila njeh nevojën urgjente për të gjitha shtetet që të marrin masa shtesë efektive për të parandaluar përhapjen e armëve bërthamore, kimike ose biologjike dhe mjetet e shpërndarjes së tyre;

duke rikujtuar më tej Konventën mbi Veprat Penale dhe disa Akte të tjera të Kryera në bordin avionit, bërë në Tokio më 14 shtator 1963; Konventën për Ndalimin e Konfiskimit të Paligjshëm të Avionëve, bërë në Hagë më 16 dhjetor 1970; Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme ndaj Sigurisë së Aviacionit Civil, bërë në Montreal më 23 shtator 1971; Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimeve kundër Personave të Mbrojtur Ndërkombëtarisht, përfshirë Agentët Diplomatikë, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 14 dhjetor 1973; Konventën Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengeve, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 17 dhjetor 1979; Konventën mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, bërë në Vjenë më 26 tetor 1979 dhe ndryshimet e tyre të miratuara më 8 korrik 2005; Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroportet që i shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar, plotësuese të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, bërë në Montreal më 24 shkurt 1988; Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në shelfin kontinental, bërë në Romë më 10 mars 1988; Konventën mbi Shënjinin e Eksplozivëve Plastikë për Qëllimin e Zbulimit, bërë në Montreal më 1 mars 1991; Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 15 dhjetor 1997; Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 dhjetor 1999 dhe Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Akteve të Terrorizmit Bërthamor të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 13 prill të vitit 2005;

duke pasur parasysh rëndësinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit, bërë në Gjirin Montego më 10 dhjetor 1982, dhe të drejtën zakonore ndërkombëtare të detit;

duke pasur parasysh Rezolutën 59/46 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila rikonfirmoi se bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe veprimet e shteteve për të luftuar terrorizmin duhet të kryhen në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, së drejtës ndërkombëtare dhe konventave përkatëse ndërkombëtare dhe Rezolutën 59/24 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila u kërkoi shteteve të bëheshin palë në Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar dhe Protokollit të saj, ftoi shtetet të marrin pjesë në shqyrtimin e këtyre instrumenteve nga Komiteti Ligjor i Organizatës Detare Ndërkombëtare për të forcuar mjetet e luftimit, të tilla si aktet e paligjshme, duke përfshirë aktet terroriste, si dhe u kërkoi shteteve të marrin masat e duhura për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre instrumenteve, veçanërisht nëpërmjet miratimit të legjislacionit, sipas rastit, me synim garantimin e një kuadri të duhur për reagimet ndaj incidenteve të grabitjes së armatosur dhe akteve terroriste në det;

duke marrë parasysh, gjithashtu, rëndësinë e ndryshimeve në Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, dhe të Kodit Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Objekteve të Porteve (ISPS), të miratuara nga Konferenca e Qeverive Kontraktuese e vitit 2002 për atë Konventë, një kuadër teknik të përshtatshëm ndërkombëtar që përfshin bashkëpunimin midis qeverive, agjencive qeveritare, administratave kombëtare dhe lokale dhe industrive të transportit detar dhe portual për të zbuluar

kërcënimet ndaj sigurisë dhe për të marrë masa parandaluese kundër incidenteve të sigurisë që prekin anijet ose objektet e porteve të përdorura në tregtinë ndërkombëtare;

duke marrë më tej parasysh Rezolutën 58/187 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila riafirmoi se shtetet duhet të sigurojnë që çdo masë e marrë për të luftuar terrorizmin është në përputhje me detyrimet e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht të drejtat ndërkombëtare të njeriut, ligjin për refugjatët dhe ligjin humanitar;

duke besuar se është e nevojshme të miratohen dispozita që plotësojnë dispozitat e Konventës për të ndaluar aktet e tjera terroriste të dhunës kundër sigurimit dhe sigurisë së lundrimit detar ndërkombëtar dhe për të përmirësuar efektivitetin e saj,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e këtij Protokoll:

1. “Konventë” nënkupton Konventën për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, bërë në Romë më 10 mars 1988.
2. “Organizatë” nënkupton Organizatën Ndër-kombëtare Detare (IMO).
3. “Sekretar i Përgjithshëm” nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

Neni 2

Neni 1 i Konventës ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

Neni 1

1. Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) “Anije” nënkupton një mjet lundrues të çfarëdo lloji që nuk është i lidhur në mënyrë të përhershme me shtratin e detit, duke përfshirë anije të mbështetur në mënyrë dinamike, nëndetëse ose ndonjë anije tjetër lundruese.

b) “Transport” nënkupton fillimin, rregullimin ose ushtrimin e kontrollit efektiv, duke përfshirë autoritetin vendimmarrës, për lëvizjen e një personi ose sendi/objekti.

c) “Lëndim ose dëmtim serioz” nënkupton:

i. lëndimin e rëndë trupor; ose

ii. shkatërrim të gjerë të një vendi të përdorimit publik, strukturë shtetërore ose qeveritare, objekti infrastrukturor ose sistemi të transportit publik, i cili rezulton në humbje të madhe ekonomike; ose

iii. dëm të konsiderueshëm në mjedis, përfshirë ajrin, tokën, ujin, faunën ose florën.

d) “Armë BCN” nënkupton:

i. “armë biologjike”, të cilat janë:

1. Agjentë mikrobikë ose agjentë të tjerë biologjikë ose toksina, pavarësisht nga origjina ose metoda e prodhimit, të llojeve dhe sasive që nuk kanë justifikim për qëllime profilaktike, mbrojtëse ose qëllime të tjera paqësore; ose

2. Armë, pajisje ose mjete të shpërndarjes të projektuara për të përdorur agjentë ose toksina të tilla për qëllime armiqësore ose në konflikt të armatosur.

ii. “armë kimike”, të cilat janë, së bashku ose veçmas:

1. Kimikate toksike dhe prekursorët e tyre, me përjashtim të rasteve, për:

A. Qëllime industriale, bujqësore, kërkimore, mjekësore, farmaceutike ose qëllime të tjera paqësore; ose

B. Qëllime mbrojtëse, specifikisht ato qëllime që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen nga kimikatat toksike dhe mbrojtjen nga armët kimike; ose

C. Qëllime ushtarake që nuk lidhen me përdorimin e armëve kimike dhe nuk varen nga përdorimi i vetive toksike të kimikateve si një metodë luftimi; ose

D. Zbatimi i ligjit, duke përfshirë qëllimet e kontrollit të brendshëm të trazirave,

për sa kohë që llojet dhe sasitë janë në përputhje me këto qëllime;

2. Municione dhe pajisje të projektuara posaçërisht për të shkaktuar vdekjen ose dëmtim tjetër nëpërmjet vetive toksike të atyre kimikateve toksike të specifikuara në nënparagrafin (ii) (1), të cilat do të çlirohen si rezultat i përdorimit të municioneve dhe pajisjeve të tilla;

3. Çdo pajisje të projektuar posaçërisht për përdorim në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me përdorimin e municioneve dhe pajisjeve të specifikuara në nënparagrafin (ii) (2).

iii. armët bërthamore dhe pajisje të tjera eksplozive bërthamore.

e) “Lëndë kimike toksike” nënkupton çdo lëndë kimike që përmes veprimit të saj kimik në proceset jetësore mund të shkaktojë vdekje, paaftësi të përkohshme ose dëmtim të përhershëm për njerëzit ose kafshët. Kjo përfshin të gjitha kimikatet e tilla, pavarësisht nga origjina ose metoda e tyre e prodhimit dhe pavarësisht nëse ato prodhohen në objekte, municione ose në vendndodhje të tjera.

f) “Prekursor” nënkupton çdo reagues kimik që merr pjesë në ndonjë fazë të prodhimit me çfarëdo metode të një lënde kimike toksike. Ky përfshin çdo komponent kyç të një sistemi kimik binar ose me shumë komponentë.

g) “Organizatë” nënkupton Organizatën Ndër-kombëtare Detare (IMO).

h) “Sekretar i Përgjithshëm” nënkupton Sekre-tarin e Përgjithshëm të Organizatës.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) Termat “vend i përdorimit publik”, “objekt shtetëror ose qeveritar”, “objekt infrastrukturor” dhe “sistem i transportit publik” kanë të njëjtin kuptim si ato të dhëna në Konventën Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, bërë në Nju-Jork më 15 dhjetor 1997; dhe

b) Termat “material burimor” dhe “material special i zbërthyeshem” kanë të njëjtin kuptim si ato të dhëna në Statutin e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), bërë në Nju-Jork më 26 tetor 1956.

Neni 3

Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 2bis i Konventës:

“Neni 2bis

1. Asgjë në këtë Konventë nuk do të ndikojë në të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shteteve dhe individëve, sipas së drejtës ndërkombëtare, në veçanti qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, ligjit për refugjatët dhe të drejtën humanitare.

2. Kjo Konventë nuk zbatohet për aktivitetet e forcave të armatosura gjatë një konflikti të armatosur, pasi këta terma kuptohen sipas së drejtës humanitare ndërkombëtare, të cilët rregullohen nga ai ligj dhe aktivitetet e ndërmarra nga forcat ushtarake të një shteti në ushtrimin e detyrat zyrtare, në masën që ato udhëhiqen nga rregulla të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

3. Asgjë në këtë Konventë nuk do të ndikojë në të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë sipas Traktatit për Mospërhapijen e Armëve Bërthamore, bërë në Uashington, Londër dhe Moskë më 1 korrik 1968, Konventën për Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit dhe Magazinimit të Armëve Bakteriologjike (Biologjike) dhe Toksinave dhe Shkatërrimin e tyre, bërë në Uashington, Londër dhe Moskë më 10 prill 1972, ose Konventën për Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit, magazinimit dhe Përdorimit të Armëve Kimike dhe për Shkatërrimin e tyre, bërë në Paris më 13 janar 1993, të shteteve palë në këto traktate.”.

Neni 4

1. Neni 3 i paragrafit 1 të Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

“Çdo person kryen një shkelje në kuptim të kësaj Konvente, nëse ai person në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme:”.

2. Neni 3, paragrafi 1 (f) i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

“f) Komunikon informacionin për të cilin ai person është në dijeni se është i rremë, duke rrezikuar në

këtë mënyrë lundrimin e sigurt të një anijeje.”.

3. Neni 3, paragrafi 1 (g) i Konventës hiqet.

4. Neni 3, paragrafi 2 i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim: “2. Çdo person kryen. Gjithashtu, një vepër penale, nëse ai person kërcënon, me ose pa kusht, siç parashikohet në të drejtën kombëtare, me synim detyrimin e një personi fizik ose juridik për të kryer ose mos kryer ndonjë veprim, për të kryer ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në paragrafët 1 (b), (c) dhe (e), nëse ky kërcënim mund të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes në fjalë.”.

5. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 3bis i Konventës:

“Neni 3bis

1. Çdo person kryen një vepër penale në kuptim të kësaj Konvente, nëse ai person në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme:

a) Kur qëllimi i veprimit, sipas natyrës ose kontekstit të tij, është që të frikësojë një popullsi ose të detyrojë një qeveri ose organizatë ndërkombëtare për të kryer, për të mos kryer ndonjë veprim:

i. përdor kundër ose në anije ose shkarkon nga një anije ndonjë material eksploziv, radioaktiv ose armë BCN, në një mënyrë që shkakton ose mund të shkaktojë vdekje ose lëndim ose dëmtimi serioz; ose

ii. shkarkon nga një anije naftë, gaz natyror të lëngshëm ose substancë tjetër të rrezikshme ose të dëmshme, e cila nuk mbulohet nga nënparagrafi (a) (i), në sasi ose përqendrim të tillë që shkakton ose mund të shkaktojë vdekje ose lëndim ose dëmtim serioz; ose

iii. përdor një anije në një mënyrë që shkakton vdekjen ose lëndimin ose dëmtimin serioz; ose

iv. kërcënon, me ose pa kushte, siç parashikohet në të drejtën kombëtare, për të kryer një vepër penale të përcaktuar në nënparagrafin (a) (i), (ii) ose (iii); ose

b) Transporton në bordin e një anijeje:

i. ndonjë material eksploziv ose radioaktiv, duke qenë në dijeni se është synuar të përdoret për të shkaktuar ose në një kërcënim për të shkaktuar me ose pa kushte, siç parashikohet në ligjin kombëtar, vdekjen ose lëndimin ose dëmtimin serioz, me qëllim për të frikësuar një popullsi ose për të detyruar një qeveri ose organizatë ndërkombëtare për të vepruar ose për të mos vepruar; ose

ii. çdo armë BCN, duke qenë në dijeni se është armë BCN, siç përcaktohet në nenin 1; ose

iii. çdo material burimor, material special të zbërthyeshëm ose pajisje, ose material të projektuar, ose të përgatitur posaçërisht për përpunimin, përdorimin ose prodhimin e materialit special të zbërthyeshëm, duke qenë në dijeni se është synuar të përdoret në një aktivitet bërthamor eksploziv ose në çdo aktivitet tjetër bërthamor jo nën masa mbrojtëse, në përputhje me një marrëveshje gjithëpërfshirëse të masave mbrojtëse të IAEA-s; ose

iv. çdo pajisje, materiale ose *software* ose teknologji të ngjashme që në mënyrë të konsiderueshme kontribuon në projektimin, prodhimin ose dorëzimin e një arme BCN, me qëllim që të përdoret për këtë qëllim.

2. Nuk do të jetë vepër penale, në kuptim të kësaj Konvente, transportimi i një sendi ose materiali të mbuluar nga paragrafi 1 (b) (iii) ose në masën që lidhet me një armë bërthamore ose pajisje të tjera eksplozive bërthamore, paragrafi 1 (b) (iv), nëse një artikull ose material i tillë transportohet në ose nga territori, ose është transportuar ndryshe nën kontrollin e një Shteti Palë të Traktatit për Mospërhapijen e Armëve Bërthamore, ku:

a) Transferimi ose marrja rrjedhuese, duke përfshirë edhe atë të brendshëm të një shteti, të artikullit ose materialit nuk është në kundërshtim me detyrimet e Palës së tillë të Shtetit, sipas Traktatit për Mospërhapijen e Armëve Bërthamore; dhe

b) Nëse artikulli ose materiali synohet për sistemin e shpërndarjes së një arme bërthamore ose mjeteve të tjera eksplozive bërthamore të një Shteti Palë të Traktatit për Mospërhapijen e Armëve Bërthamore, mbajtja e një arme ose pajisjeje të tillë nuk është në kundërshtim me detyrimet e Shtetit Palë sipas atij

Traktati.”.

6. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 3ter i Konventës:

“Neni 3ter

Çdo person kryen një vepër penale në kuptim të kësaj Konvente, nëse ai person në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme transporton një person tjetër në bordin e një anijeje, duke qenë në dijeni se personi ka kryer një veprim që përbën vepër penale të parashikuar në nenin 3, 3bis ose 3ter ose një vepër penale në çdo traktat të renditur në shtojcë dhe duke synuar që ta ndihmojë atë person për t’iu shmangur ndjekjes penale.”.

7. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 3quater i Konventës:

“Neni 3quater

Çdo person kryen, gjithashtu, vepër penale, në kuptimin e kësaj Konvente, nëse ai person:

- a) Lëndon ose vret në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme ndonjë person në lidhje me kryerjen e ndonjë prej veprave penale të përcaktuara në nenin 3, paragrafi 1, neni 3bis ose neni 3ter; ose
- b) Kryen një vepër penale në tentativë, të përcaktuar në nenin 3, paragrafi 1, neni 3bis, paragrafi 1 (a) (i), (ii) ose (iii) ose nënparagrafi (a) i këtij neni; ose
- c) Merr pjesë si bashkëpunëtor në një shkelle të parashikuar në nenin 3, nenin 3bis, nenin 3ter, ose nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni; ose
- d) Organizon ose drejton të tjerët për të kryer një vepër penale të përcaktuar në nenin 3, nenin 3bis, nenin 3ter ose nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni; ose
- e) Kontribuon në kryerjen e një ose më shumë veprave penale të parashikuara në nenin 3, nenin 3bis, nenin 3ter ose nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni, nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët, në mënyrë të qëllimshme; dhe, ose:
 - i. me qëllim të ndihmës për zhvillim të veprimtarisë kriminale ose qëllimit kriminal të grupit, kur një aktivitet ose qëllim i tillë përfshin kryerjen e një veprave penale të përcaktuara në nenin 3, 3bis ose 3ter; ose
 - ii. në njohurinë e qëllimit të grupit për të kryer një vepër penale të parashikuar në nenin 3, 3bis ose 3ter.”.

Neni 5

1. Neni 5 i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

“Çdo Shtet Palë do të kryejë veprat penale të përcaktuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, të dënueshme me dënime të përshtatshme, të cilat marrin parasysh natyrën e rëndë të këtyre veprave penale.”.

2. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 5bis i Konventës:

“Neni 5bis

1. Çdo Shtet Palë, në përputhje me parimet e saj të brendshme ligjore, do të marrë masat e nevojshme për të mundësuar që një person juridik, i vendosur në territorin e tij ose i organizuar sipas ligjeve të tij, të jetë përgjegjës kur personi përgjegjës për menaxhimin ose kontrollin e atij personi juridik, në atë cilësi, ka kryer një vepër penale të përcaktuar në këtë Konventë. Një përgjegjësi e tillë mund të jetë penale, civile ose administrative.

2. Kjo përgjegjësi shkaktohet pa cenuar përgjegjësinë penale të individëve që kanë kryer veprat penale.

3. Çdo Shtet Palë duhet të sigurojë, në veçanti, që personat juridikë përgjegjës, në përputhje me paragrafin 1 të jenë subjekt i sanksioneve penale, civile ose administrative efektive, proporcionale dhe bindëse. Sanksionet e tilla mund të përfshijnë sanksione monetare.”.

Neni 6

1. Kapitulli i nenit 6, paragrafi 1 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

“1. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, kur vepra është kryer.”.

2. Neni 6, paragrafi 3 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

“3. Çdo Shtet Palë që ka vendosur juridiksionin e përmendur në paragrafin 2 duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm. Nëse një Shtet Palë i tillë më pas e shfuqizon atë juridiksion, ajo do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm.”.

3. Neni 6, paragrafi 4 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

“4. Çdo Shtet Palë do të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, në rastet kur autori i dyshuar ndodhet në territorin e tij dhe nuk ekstradon shkelësin e dyshuar në cilindo nga Shtetet Palë që kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.”.

Neni 7

Teksti i mëposhtëm është shtuar si Shtojca e Konventës:

“SHTOJCË

1. Konventa për Ndalimin e Konfiskimit të Paligjshëm të Avionëve, bërë në Hagë më 16 dhjetor 1970.
2. Konventa për Ndalimin e Akteve të Paligjshme ndaj Sigurisë së Aviacionit Civil, bërë në Montreal më 23 shtator 1971.
3. Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimeve kundër Personave të Mbrojtur Ndërkombëtarisht, përfshirë agjentët diplomatikë, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 14 dhjetor 1973.
4. Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 17 dhjetor 1979.
5. Konventa për Mbrojtjen Fizike të Materialit Bërthamor, bërë në Vjenë më 26 tetor 1979.
6. Protokolli për Ndalimin e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroporte që i Shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar, në plotësim të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme ndaj Sigurisë së Aviacionit Civil, bërë në Montreal më 24 shkurt 1988.
7. Protokolli për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental, bërë në Romë më 10 mars 1988.
8. Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 15 dhjetor 1997.
9. Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 9 dhjetor 1999.”.

Neni 8

1. Neni 8, paragrafi 1 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

“1. Zotëruesi i një anijeje të një Shteti Palë (Shteti i flamurit) mund të dorëzojë tek autoritetet e çdo Shteti tjetër Palë (Shteti pritës) çdo person për të cilin kapiteni i anijes ka arsye bindëse për të besuar se ka kryer një vepër penale të përcaktuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater.”.

2. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 8bis i Konventës:

“Neni 8bis

1. Shtetet Palë do të bashkëpunojnë, në masën më të plotë të mundshme, për të parandaluar dhe për të ndaluar aktet e paligjshme të mbuluara nga kjo Konventë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe

do t'u përgjigjen kërkesave sipas këtij neni sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Çdo kërkesë sipas këtij neni, nëse është e mundur, duhet të përmbajë emrin e anijes së dyshuar, numrin identifikues të anijes së IMO-s, portin e regjistrimit, portet e origjinës dhe destinacionit dhe çdo informacion tjetër përkatës. Nëse kërkesa përcillet verbalisht, Pala kërkuuese do ta konfirmojë kërkesën me shkrim sa më parë që të jetë e mundur. Pala e kërkuar do të konfirmojë menjëherë pranimin e saj të çdo kërkesë me shkrim ose verbalisht.

3. Shtetet Palë do të marrin në konsideratë rreziqet dhe vështirësitë e përfshira në hipjen në anije në det dhe në kërkim të ngarkesës së saj, dhe do të shqyrtojnë nëse masat e tjera të përshtatshme të rëna dakord midis shteteve të interesuara mund të merren në mënyrë më të sigurt në portin e ardhshëm të thirrjes ose në vendndodhje të tjera.

4. Një Shtet Palë që ka arsye bindëse për të dyshuar se një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater është kryer, po kryhet ose do të kryhet, duke përfshirë një anije që valëvit flamurin e saj, mund të kërkojë ndihmën e shteteve të tjera Palë në parandalimin ose ndalimin e kësaj veprë penale. Shtetet Palë që kanë kërkuar në këtë mënyrë, duhet të ushtrojnë përpjekjet e tyre më të mira për të dhënë një ndihmë të tillë brenda mjeteve në dispozicion të tyre.

5. Kurdo që zyrtarët e zbatimit të ligjit ose zyrtarët e tjerë të autorizuar të një Shteti Palë (Pala kërkuuese) ndeshen me një anije që valëvit flamurin ose shfaq shenjat e regjistrimit të një Shteti tjetër Palë (Pala e Parë) që ndodhet në drejtimin e detit territorial të ndonjë shteti dhe Pala kërkuuese ka arsye bindëse për të dyshuar se anija ose personi në bordin e anijes ka qenë, është ose do të përfshihet në kryerjen e një veprë penale të parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater dhe Pala kërkuuese dëshiron të hipë në anije,

a) Do të kërkojë, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, që Pala e Parë të konfirmojë pretendimin e shtetësisë; dhe

b) Nëse konfirmohet shtetësia, Pala kërkuuese do t'i kërkojë Palës së parë (në vijim i referuar si "Shteti i flamurit") për autorizim të bordit dhe të marrë masat e duhura në lidhje me atë anije që mund të përfshijë ndalimin, hipjen dhe kërkimin anijeve, ngarkesave të tij dhe të personave në bord, dhe marrjen në pyetje të personave në bord për të përcaktuar nëse një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater është duke u kryer apo do të kryhet; dhe

c) Shteti i flamurit ose do të:

i. autorizojë Palën kërkuuese të hipë në anije dhe të ndërmarrë masat e duhura të përcaktuara në nënparagrafin (b), në bazë të kushteve që mund të vendosë në përputhje me paragrafin 7; ose

ii. realizojë hipjen në anije dhe kërkimin me zyrtarët e vet të zbatimit të ligjit ose zyrtarë të tjerë; ose

iii. realizojë hipjen në anije dhe kërkimin së bashku me Palën kërkuuese, në bazë të kushteve që mund të vendosë në përputhje me paragrafin 7; ose

iv. refuzojë autorizimin e hipjes në anije dhe kërkimin.

Pala kërkuuese nuk mund të hipë në anije ose nuk mund të marrë masat e përcaktuara në nënparagrafin (b) pa autorizimin e shprehur të shtetit të flamurit.

d) Në momentin e, ose pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, se, në lidhje me anijet që valëvisin flamurin e tij ose shfaqin shenjën e tij të regjistrimit, Palës kërkuuese i jepet autorizim për të hipur dhe për të kontrolluar anijen, ngarkesën e saj dhe personat në bord dhe për të pyetur personat në bord për të gjetur dhe për të shqyrtuar dokumentacionin e kombësisë së saj, dhe për të përcaktuar nëse një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater është kryer, është duke u kryer ose do të kryhet, nëse nuk ka përgjigje nga Pala e parë brenda katër orëve nga pranimi i marrjes së një kërkesë për të konfirmuar shtetësinë.

e) Në momentin e, ose pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, se, në lidhje me Palës kërkuuese i jepet autorizim për të hipur dhe për të kontrolluar anijen, anijet që valëvisin flamurin e tij ose shfaqin shenjën e tij të regjistrimit dhe të kërkojë një anije, ngarkesën e tij dhe personat në bord, dhe për të pyetur personat në

bord për të përcaktuar nëse një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater ka qenë kryer, është duke u kryer ose do të kryhet.

Njoftimet e bëra sipas këtij paragrafi mund të tërhiqen në çdo kohë.

6. Kur dëshmia e kryerjes e përshkruar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater është gjetur si rezultat i çdo bordi të kryer sipas këtij neni, shteti flamur mund të autorizojë Palën kërkuese që të ndalojë anijen, ngarkesën dhe personat në bord, në pritje të marrjes së udhëzimeve të disponimit nga shteti i flamurit. Pala kërkuese menjëherë do të informojë shtetin e flamurit mbi rezultatet e bordit, kërkimin dhe ndalimin e kryer sipas këtij neni. Pala kërkuese, gjithashtu, do të informojë menjëherë shtetin flamur për zbulimin e provave të kryerjes së paligjshme që nuk i nënshtrohet kësaj Konvente.

7. Shteti i flamurit, në përputhje me dispozitat e tjera të kësaj Konvente, mund t'i nënshtrohet autorizimit të tij, sipas paragrafit 5 ose 6 të kushteve, duke përfshirë marrjen e informacionit shtesë nga Pala kërkuese dhe kushteve në lidhje me përgjegjësinë dhe shtrirjen e masave që duhet të ndërmerren. Asnjë masë shtesë nuk mund të merret pa autorizimin e shprehur të shtetit të flamurit, përveç kur është e nevojshme për të lehtësuar rrezikun e menjëhershëm për jetën e personave ose kur ato masa rrjedhin nga marrëveshjet përkatëse dypalëshe ose shumëpalëshe.

8. Për të gjitha bordet sipas këtij neni, shteti i flamurit ka të drejtë të ushtrojë juridiksion mbi një anije, ngarkesë ose sende të tjera të ndaluara, si dhe personave në bord, duke përfshirë konfiskimin, sekuestrimin, ndalimin dhe ndjekjen penale. Megjithatë, sipas kushtetutës dhe ligjeve të tij, shteti i flamurit mund të miratojë ushtrimin e juridiksionit nga një shtet tjetër që ka juridiksion sipas nenit 6.

9. Gjatë kryerjes së veprimeve të autorizuara sipas këtij neni, përdorimi i forcës duhet të shmanget, përveç kur është e nevojshme për të garantuar sigurinë e zyrtarëve të tij dhe të personave në bord ose kur zyrtarët pengohen në kryerjen e veprimeve të autorizuara. Çdo përdorim i forcës sipas këtij neni nuk duhet të tejkalojë shkallën minimale të forcës që është e nevojshme dhe e arsyeshme sipas rrethanave.

10. Masat mbrojtëse:

a) Kur një Shtet Palë merr masa kundër një anijeje, në përputhje me këtë nen, ai duhet:

- i. të marrë parasysh nevojën për të mos rrezikuar sigurinë e jetës në det;
- ii. të sigurojë që të gjithë personat në bord të trajtohen në një mënyrë që ruan dinjitetin e tyre themelor njerëzor dhe në përputhje me dispozitat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- iii. të sigurojë që një hipje në anije dhe kërkim sipas këtij neni, të kryhet në përputhje me ligjin ndërkombëtar në fuqi;
- iv. të marrë parasysh sigurinë dhe sigurinë e anijes dhe ngarkesës së tij;
- v. të marrë parasysh nevojën për të mos paragjykuar interesat komerciale ose ligjore të shtetit flamur;
- vi. të sigurojë, brenda mjeteve të disponueshme, që çdo masë e marrë në lidhje me anijen ose ngarkesën e saj është e përshtatshme për mjedisin;
- vii. të sigurojë që personave në bord, kundër të cilëve mund të fillojnë procedimet në lidhje me ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater, t'u sigurohet mbrojtja sipas paragrafit 2 të nenit 10, paravarsisht vendndodhjes;
- viii. të sigurojë që kapiteni i një anijeje të këshillohet për qëllimin e tij për të hipur dhe i jepet ose i është dhënë mundësia të kontaktoj pronarin e anijes dhe shtetin e flamurit, sa më shpejt që të jetë e mundur;

dhe

ix. të ndërmarrë përpjekje të arsyeshme për të shmangur një anije të ndaluar ose të vonuar.

b) Me kusht që autorizimi për t'u bartur nga një shtet flamur nuk do të rezultojë në përgjegjësinë e tij, Shtetet Palë do të jenë përgjegjëse për çdo dëm, dëmtim apo humbje që u atribuohet atyre, të cilat rrjedhin nga masat e marra në zbatim të këtij neni, kur:

i. arsyet për masa të tilla nuk janë të bazuara, me kusht që anija të mos ketë kryer asnjë veprim që justifikon masat e marra; ose

ii. masa të tilla janë të paligjshme ose tejkalojnë ato që kërkohen në mënyrë të arsyeshme, duke marrë

parasysh informacionin në dispozicion për të zbatuar dispozitat e këtij neni. Shtetet Palë do të sigurojnë një mbështetje të efektshme në lidhje me një dëm, dëmtim apo humbje të tillë.

c) Kur një Shtet Palë merr masa kundër një anijeje në përputhje me këtë Konventë, duhet të marrë në konsideratë nevojën për të mos ndërhyrë ose ndikuar:

i. në të drejtat dhe detyrimet dhe ushtrimi i juridiksionit të shteteve bregdetare, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të detit; ose

ii. në autoritetin e shtetit të flamurit për të ushtruar juridiksion dhe kontroll në çështjet administrative, teknike dhe sociale që përfshijnë anijen.

d) Çdo masë e marrë sipas këtij neni do të kryhet nga zyrtarët e zbatimit ligjit ose nga zyrtarë të tjerë të autorizuar nga anijet luftarake ose avionë ushtarakë ose nga anije ose avionë të tjerë të shënjuar qartë dhe të identifikueshëm si të shërbimit të qeverisë dhe të autorizuar për këtë qëllim dhe, nenet 2 dhe 2bis do të zbatohen sipas dispozitave të këtij neni.

e) Për qëllimet e këtij neni, “zyrtarë të zbatimit të ligjit ose zyrtarë të tjerë të autorizuar” nënkupton anëtarë të veshur me uniformë ose ndryshe qartësisht të identifikueshëm të organeve të zbatimit të ligjit ose të autoriteteve të tjera qeveritare të autorizuar, siç duhet nga qeveria e tyre. Për qëllimin specifik të zbatimit të ligjit sipas kësaj Konvente, zyrtarë të zbatimit të ligjit ose zyrtarë të tjerë të autorizuar duhet të ofrojnë dokumente të përshtatshme identifikimi të lëshuara nga qeveria për shqyrtim nga ana e kapitenit të anijes gjatë hipjes në anije.

11. Ky nen nuk zbatohet ose kufizohet me hipjen në anije, të kryera nga çdo shtet palë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, në drejtim të detit territorial të çdo shteti, duke përfshirë hipjet në anije të bazuara në të drejtën e vizitës, dhënien e ndihmës për personat, anijet dhe pronat në situatë problematike ose rrezik, ose një autorizim nga shteti i flamurit për të marrë masa për zbatimin e ligjit ose masa të tjera.

12. Shtetet Palë inkurajohen që të zhvillojnë procedura standarde funksionale për operacionet e përbashkëta në pajtim me këtë nen dhe të konsultohen, sipas rastit, me Palët e tjera Shtetërore, me qëllim harmonizimin e procedurave të tilla standarde funksionale për kryerjen e operacioneve.

13. Shtetet Palë mund të lidhin marrëveshje ose masa ndërmjet tyre për të lehtësuar veprimet e zbatimit të ligjit të kryera në përputhje me këtë nen.

14. Secili Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura për të siguruar që zyrtarët e tij të zbatimit të ligjit ose zyrtarë të tjerë të autorizuar dhe zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit ose të autorizuar të shteteve të tjera palë që veprojnë në emër të tij, të jenë të autorizuar për të vepruar sipas këtij neni.

15. Në momentin e, ose pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, çdo Shtet Palë do të caktojë autoritetin ose, kur është e nevojshme, autoritetet për të marrë dhe për t’iu përgjigjur kërkesave për ndihmë, për konfirmimin e shtetësisë dhe autorizimin për të marrë masat e duhura. Një përcaktim i tillë, duke përfshirë informacionin e personit të kontaktit, duhet t’i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm brenda një muaji nga bërja Palë, i cili do të informojë të gjitha Shtetet e tjera Palë brenda një muaji nga përcaktimi. Secili Shtet Palë është përgjegjës për njoftimin e menjëhershëm nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm për çdo ndryshim në përcaktimin ose informacionin e personit të kontaktit.”.

Neni 9

Neni 10, paragrafi 2, zëvendësohet me tekstin në vijim:

“2. Çdo person në paraburgim ose për të cilin merren masa të tjera ose për të cilin janë duke u zhvilluar procedime në pajtim me këtë Konventë, garantohet trajtimi i drejtë, duke përfshirë gëzimin e të gjitha të drejtave dhe garancive, në përputhje me ligjin e shtetit në territorin e të cilit ndodhet dhe dispozitat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.”.

Neni 10

Neni 11, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, janë zëvendësuar me tekstin në vijim:

“1. Veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater do të konsiderohen të përfshihen si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që ekziston ndërmjet ndonjë prej Shteteve Palë. Shtetet Palë marrin përsipër të përfshijnë vepra të tilla si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që do të lidhet ndërmjet tyre.

2. Nëse një Shtet Palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një traktati, pranon një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë, me të cilin nuk ka traktate për ekstradim, Shteti Palë i kërkuar mund të zgjedhë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradim, në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater. Ekstradimi u nënshtrohet kushteve të tjera të parashikuara nga ligji i shtetit palë të kërkuar.

3. Shtetet Palë që nuk e kushtëzojnë ekstradimin nga ekzistenca e një traktati, duhet të njohin veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, si vepra të ekstradueshme ndërmjet tyre, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i shtetit palë të kërkuar.

4. Nëse është e nevojshme, veprat penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater do të trajtohen, për qëllime të ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë, sikur të ishin kryer jo vetëm në vendin ku ndodheshin, por edhe në një vend brenda juridiksionit të Shtetit Palë që kërkon ekstradimin.”.

2. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 11bis i Konventës:

“Neni 11bis

Asnjë nga shkeljet e parashikuara në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater nuk konsiderohet për qëllime të ekstradimit ose të ndihmës së ndërsjellë juridike si vepër politike ose si vepër penale e lidhur me një vepër politike ose si vepër e frymëzuar nga motive politike. Si rrjedhojë, kërkesa për ekstradim ose ndihmë të ndërsjellë juridike, bazuar në një shkelje të tillë nuk mund të refuzohet vetëm për shkak se lidhet me një vepër politike apo vepër penale të lidhur me një vepër politike ose vepër të frymëzuar nga motive politike.”.

3. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 11ter i Konventës:

“Neni 11ter

Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si detyrim për të ekstraduar ose për të ofruar ndihmë të ndërsjellë juridike, nëse Shteti Palë i kërkuar ka arsye bindëse për të besuar se kërkesa për ekstradim për veprat penale të përcaktuara në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater ose për ndihmën e ndërsjellë juridike, në lidhje me këto vepra penale, është bërë me qëllim të ndjekjes penale ose të dënimit të një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike, mendimit politik ose gjinisë së atij personi, ose që pajtueshmëria me kërkesën do të cenonte pozicionin e personit për ndonjë nga këto arsye.”.

Neni 11

1. Neni 12, paragrafi 1 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

“1. Shtetet Palë i ofrojnë njëri-tjetrit masën më të madhe të ndihmës në lidhje me procedimet penale të filluara, për shkeljet e parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, duke përfshirë ndihmën në marrjen e provave në dispozicion të tyre, të nevojshme për procedimet.”.

2. Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 12bis i Konventës:

“Neni 12bis

1. Personi i cili ndodhet në paraburgim ose është duke kryer një dënim në territorin e një Shteti Pale,

prania e të cilit në një Shtet tjetër Palë kërkohet për qëllime të identifikimit, dëshmisë ose ndryshe dhënies së ndihmës në marrjen e provave për hetimin ose ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater, mund të transferohet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Personi jep lirisht pëlqimin e vetëdijshëm; dhe
b) Autoritetet kompetente të të dyja shteteve bien dakord, në bazë të kushteve të tilla që ato shtete mund të konsiderojnë të përshtatshme.

2. Për qëllimet e këtij neni:

a) Shteti në të cilin transferohet personi ka autoritetin dhe detyrimin për ta mbajtur personin e transferuar në paraburgim, përveç nëse kërkohet ose autorizohet ndryshe nga shteti nga i cili është transferuar personi;

b) Shteti në të cilin transferohet personi do të zbatojë pa vonesë detyrimin e tij për kthimin e personit në paraburgim të shtetit nga i cili personi transferohet, siç është rënë dakord paraprakisht ose siç është rënë dakord ndryshe nga autoritetet kompetente të të dyja shteteve;

c) Shteti në të cilin transferohet personi, nuk do të kërkojë nga shteti nga i cili është transferuar personi, fillimin e procedurave të ekstradimit për kthimin e personit;

d) Personi i transferuar do të marrë konfirmimin për kryerjen e dënimit që kryhet në shtetin nga i cili personi është transferuar për periudhën e kaluar në paraburgim të shtetit në të cilin është transferuar personi.

3. Përveç nëse shteti palë nga i cili një person duhet të transferohet në përputhje me këtë nen bie dakord për këtë, ai person, me çfarëdo lloj shtetësie, nuk do të ndiqet penalisht, nuk do të ndalohej ose nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale në territorin e shtetit në të cilin ky person transferohet, në lidhje me veprat ose dënimet e mëparshme përpara largimit të atij personi nga territori i shtetit nga i cili ky person është transferuar.”.

Neni 12

Neni 13 i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

“1. Shtetet Palë bashkëpunojnë për para-ndalimin e veprave penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater, veçanërisht nga:

a) Marrja e të gjitha masave praktike për të parandaluar përgatitjen në territoret e tyre përkatëse për kryerjen e atyre veprave penale brenda ose jashtë territoreve të tyre;

b) Shkëmbimi i informacionit në përputhje me të drejtën e tyre kombëtare dhe bashkërendimin e masave administrative dhe masave të tjera të marra sipas rastit, për të parandaluar kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 3, 3bis, 3ter dhe 3quater.

2. Kur për shkak të kryerjes së një vepre penale të përcaktuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater, kalimi i një anijeje është vonuar ose ndërprerë, çdo Shtet Palë në territorin e së cilës ndodhet anija, udhëtarët ose ekuipazhi, duhet të jetë i detyruar të ushtrojë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur një anije, pasagjerët, ekuipazhin ose ngarkesën e tij që mbahet në mënyrë të padrejtë ose të vonuar.”.

Neni 13

Neni 14 i Konventës zëvendësohet me tekstin në vijim:

“Çdo Shtet Palë që ka arsye të besojë se do të kryhet një vepër penale e parashikuar në nenin 3, 3bis, 3ter ose 3quater, në përputhje me të drejtën e tij kombëtare, do të japë sa më shpejt të jetë e mundur çdo informacion përkatës në zotërim të tij ndaj atyre shteteve që çmon se do të ishin shtetet që kanë vendosur juridiksionin në përputhje me nenin 6.”.

Neni 14

Neni 15, paragrafi 3 i Konventës, zëvendësohet me tekstin në vijim:

“3. Informacioni i transmetuar, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, do të komunikohet nga Sekretari i

Përgjithshëm për të gjitha Shtetet Palë, anëtarët e Organizatës, shtetet e tjera të interesuara dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare ndërqeveritare.”.

Neni 15

Interpretimi dhe zbatimi

1. Konventa dhe ky Protokoll, si ndërmjet palëve të këtij Protokoll, do të lexohen dhe interpretohen së bashku si një instrument i vetëm.

2. Nenet 1 deri 16 të Konventës, të rishikuara nga ky Protokoll, së bashku me nenet 17 deri 24 të këtij Protokoll dhe shtojcën e saj, përbëjnë dhe emërtohen Konventa për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar 2005 (Konventa e SUA-së e vitit 2005).

Neni 16

Teksti i mëposhtëm është shtuar si neni 16bis i Konventës:

“Klauzolat përfundimtare të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar 2005

Klauzolat përfundimtare të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar të vitit 2005 janë nenet 17 deri 24 të Protokollit të vitit 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar. Referencat në këtë Konventë për Shtetet Palë do të nënkuptohen si referenca për Shtetet Palë të atij Protokollit.”.

KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës nga data 14 shkurt 2006 deri më 13 shkurt 2007 dhe më pas do të mbetet i hapur për aderim.

2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u detyruar nga ky Protokoll, nga:

- a) Nënshkrimi pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin; ose
- b) Nënshkrimi që u nënshtrohet ratifikimit, pranimin ose miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose
- c) Aderimi.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi kryhen me depozitimin e një instrumenti për këtë qëllim pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Vetëm një Shtet që ka nënshkruar Konventën pa rezerva për ratifikimin, pranimin ose miratimin ose ka ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në Konventë, mund të bëhet Palë e këtij Protokoll.

Neni 18

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën dymbëdhjetë shtete e kanë nënshkruar atë pa rezerva për ratifikimin, pranimin ose miratimin ose kanë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Për një shtet që depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, në lidhje me këtë Protokoll, pasi të jenë plotësuar kushtet për paragrafin 1 për hyrjen e tij në fuqi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, do të hyjnë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të tillë.

Neni 19
Denoncimi

1. Ky Protokoll mund të denoncohet nga çdo Shtet Palë në çdo kohë pas datës në të cilën ky Protokoll hyn në fuqi për atë Shtet.
2. Denoncimi kryhet me depozitimin e një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.
3. Një denoncim do të hyjë në fuqi një vit ose në një periudhë më të gjatë që mund të përcaktohet në instrumentin e denoncimit, pas depozitimit të instrumentit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 20
Rishikimi dhe ndryshimi

1. Konferenca, me qëllim të rishikimit ose të ndryshimit të këtij Protokollit, mund të thirret nga Organizata.
2. Sekretari i Përgjithshëm do të thërrasë një konferencë të Shteteve Palë të këtij Protokollit për rishikimin ose ndryshimin e Protokollit, me kërkesën e një të tretës së Shteteve Palë ose dhjetë Shteteve Palë, cilado që është shifra më e lartë.
3. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i depozituar pas datës së hyrjes në fuqi të një amendimi të këtij protokollit do të konsiderohet se zbatohet në Protokoll, të ndryshuar.

Neni 21
Deklaratat

1. Pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë që nuk është palë në një traktat të renditur në shtojcë mund të deklarojë që në zbatimin e këtij Protokollit për Palën Shtetërore, traktati konsiderohet të mos përfshihet në nenin 3ter. Deklarata pushon së qeni në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Shtetin Palë, i cili do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për këtë fakt.
2. Kur një Shtet Palë nuk është më palë në një traktat të renditur në shtojcë, mund të bëjë një deklaratë siç parashikohet në këtë nen, në lidhje me atë traktat.
3. Pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë mund të deklarojë se do të zbatojë dispozitat e nenit 3ter, në përputhje me parimet e Së drejtës së tij penale në lidhje me përjashtimet familjare të përgjegjësisë.

Neni 22
Ndryshimet në shtojcë

1. Shtojca mund të ndryshohet me shtimin e traktateve përkatëse, që:
 - a) Janë të hapura për pjesëmarrjen e të gjitha shteteve;
 - b) Kanë hyrë në fuqi; dhe
 - c) Janë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar nga të paktën dymbëdhjetë Shtete Palë të këtij Protokollit.
2. Pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit, çdo Shtet Palë mund të propozojë një ndryshim të tillë në shtojcë. Çdo propozim për një ndryshim do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm në formë të shkruar. Sekretari i Përgjithshëm do të qarkullojë çdo amendament të propozuar që plotëson kërkesat e paragrafit 1 të të gjithë anëtarët e Organizatës dhe kërkon nga Shtetet Palë të këtij Protokollit pëlqimin e tyre për miratimin e amendimit të propozuar.
3. Amendimi i propozuar i shtojcës do të konsiderohet i miratuar pasi më shumë se dymbëdhjetë Shtete Palë të këtij Protokollit ta kenë miratuar me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Amendimi i miratuar i shtojcës do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të instrumentit të dymbëdhjetë të ratifikimit, pranimi ose miratimit të amendimit të tillë për ato Shtete Palë të këtij Protokollit që kanë depozituar një instrument të tillë. Për çdo Shtet Palë të këtij Protokollit që ratifikon, pranon ose miraton ndryshimin pas depozitimit të instrumentit të dymbëdhjetë pranë Sekretarit të Përgjithshëm, amendimi hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga një Shtet Anëtar i tillë të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

Neni 23 **Depozitari**

1. Ky Protokoll dhe çdo amendament i miratuar sipas neneve 20 dhe 22 do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të:

- a) Informojë të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose kanë aderuar në këtë Protokoll:
 - i. secilin nënshkrim ose depozitim të ri të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, së bashku me datën e tij;
 - ii. datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokollit;
 - iii. depozitohet ndonjë instrument të denoncimit të këtij Protokollit, së bashku me datën në të cilën është pranuar dhe datën kur denoncimi hyn në fuqi;
 - iv. çdo komunikim të kërkuar nga ndonjë nen i këtij protokollit;
 - v. çdo propozim për ndryshimin e shtojcës që është bërë në përputhje me nenin 22, paragrafi 2;
 - vi. çdo amendament që konsiderohet të jetë miratuar në përputhje me nenin 22, paragrafi 3;
 - vii. çdo ndryshim i ratifikuar, pranuar ose miratuar në përputhje me nenin 22, paragrafi 4, së bashku me datën në të cilën ndryshimi do të hyjë në fuqi; dhe
- b) Transmetojë kopje të vërtetuara të njësuara me origjinalin të këtij Protokollit për të gjitha shtetet që kanë nënshkruar ose aderuar në këtë Protokoll.

3. Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Protokollit, Sekretari i Përgjithshëm do të transmetojë një kopje të vërtetuar të njësuar me origjinalin të Sekretarit të Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 24 **Gjuhët**

Ky Protokoll është hartuar në një origjinal të vetëm në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëloj autentik.

Bërë në Londër, në datën katërmëdhjetë tetor dy mijë e pesë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

PROTOKOLLI I 2005-ës I PROTOKOLLIT PËR NDALIMIN E AKTEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË PLATFORMAVE FIKSE NË SHELFIN KONTINENTAL

Shtetet Palë të këtij Protokollit,

duke qenë palë të këtij Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, të nënshkruar në Romë në datën 10 mars 1988;

duke pranuar se arsyet për të cilat Protokollit i vitit 2005 i Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar u shtjellua edhe për aplikimin për platformat fikse të vendosura në shelfin kontinental;

duke pasur parasysh dispozitat e atyre Protokolleve,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllime të këtij Protokollit:

1. “Protokoll i vitit 1988” do të thotë Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, i nënshkruar në Romë më 10 mars 1988.
2. “Organizatë” do të thotë Organizata Ndër-kombëtare Detare.
3. “Sekretar i Përgjithshëm” do të thotë Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës.

Neni 2

Neni 1, paragrafi 1 i Protokollit të vitit 1988, është zëvendësuar nga teksti i mëposhtëm:

“1. Dispozitat e nenit 1, paragrafët 1(c), (d), (e), (f), (g), (h) dhe 2 (a) të neneve 2, 5, 7 dhe të neneve 10 deri te 16, duke përfshirë nenet 11, 12 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, të ndryshuar nga Protokollit i vitit 2005, i Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, do të zbatohen edhe për ndryshimet e nevojshme për veprat penale të përcaktuara në nenin 2 të këtij Protokollit, kur vepra penale të tilla janë kryer në bord ose kundrejt platformave fikse në shelfin kontinental.”.

Neni 3

1. Neni 2, paragrafi 1 (d) i Protokollit të 1988-ës, është zëvendësuar nga teksti i mëposhtëm:

“d) Vendos ose merr masa për vendosjen në një platformë fikse, me çdo mënyrë, të një pajisjeje ose substance, e cila mund ta shkatërrojë atë platformë fikse ose mund ta rrezikojë sigurinë e saj.”.

2. Neni 2, paragrafi 1 (e) i Protokollit 1988, është zëvendësuar nga teksti i mëposhtëm:

“Gjithashtu, çdo person kryen një vepër penale nëse kërcënon, me ose pa kushte, siç parashikohet sipas ligjit, me qëllim detyrimin e një personi fizik ose juridik për të kryer ose jo ndonjë akt, për të kryer ndonjë prej veprave penale siç parashikohen në paragrafët 1 (b) dhe (c), nëse ai kërcënim mund të rrezikojë sigurinë e platformës fikse.”.

Neni 4

1. Teksti i mëposhtëm është përfshirë si neni 2bis:

“Neni 2bis

Çdo person që kryen një vepër penale brenda kuptimit të këtij Protokollit, nëse ky person në mënyrë të paligjshme ose qëllimisht, kur qëllimi i aktit, nga natyra ose konteksti, është që të frikësojë popullsinë ose të detyrojë qeverinë ose një organizatë ndërkombëtare për të kryer ose jo një akt të caktuar:

a) Përdor kundrejt ose në një platformë fikse ose lëshon nga një platformë fikse lëndë eksplozive, materiale radioaktive ose armë të shkatërrimit në masë në një mënyrë që shkakton ose mund të shkaktojë vdekjen ose dëme serioze ose lëndime; ose

b) Lëshon nga një platformë fikse, vaj, gaz të lëngshëm ose substanca të tjera të dëmshme që nuk përfshihen në nënparagrafin (a), në sasi të tilla ose përqendrim që mund të shkaktojë vdekjen ose dëme ose lëndime; ose

c) Kërcënon, siç parashikohet me ligj, për të kryer një vepër penale, sipas nënparagrafët (a) ose (b).”.

2. Teksti i mëposhtëm është përfshirë si neni 2ter:

“Neni 2ter

Një person kryen, gjithashtu, një vepër penale, nëse brenda kuptimit të këtij Protokollit:

- a) Plagos ose vret qëllimisht dhe në mënyrë të paligjshme një person në lidhje me kryerjen e ndonjë prej veprave penale të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1 ose neni 2 bis; ose
- b) Tenton të kryejë një vepër penale të përcaktuar në nenin 2, paragrafi 1, neni 2 bis, nënparagrafët (a) ose (b) ose nënparagrafi (a) i këtij neni ose
- c) Merr pjesë si bashkëfajtor në një vepër penale të përcaktuar në nenin 2, nenin 2 bis ose në nënparagrafët 9(a) ose (b) të këtij neni; ose
- d) Organizon ose drejton të tjerët për të kryer një vepër penale të përcaktuar në nenin 2, neni 2 bis apo nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni; ose
- e) Kontribuon në kryerjen e një ose më shumë veprave penaleve të përcaktuara në nenin 2, nenin 2 bis apo nënparagrafët (a) ose (b) të këtij neni, nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët, qëllimisht:
 - i. me qëllim vazhdimin e veprimtarisë kriminale apo qëllimit kriminal të grupit, ku veprimtaria apo qëllime të tilla përfshijnë kryerjen e një vepre penaleje të përcaktuar në nenin 2 apo 2bis; ose
 - ii. në dijeninë e qëllimit të grupit për të kryer një vepër penale të përcaktuar në nenin 2 ose nenin 2bis.”.

Neni 5

1. Neni 3, paragrafi 1 i Protokollit 1988, është zëvendësuar me tekstin e mëposhtëm:

“1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të përcaktuara në nenet 2, 2bis dhe 2ter kur kryhet vepra penale:

- a) Kundër ose në bordin e një platforme fikse kur është e vendosur në Shelfin Kontinental të atij Shteti; ose
- b) Nga një shtetas i atij Shteti.”.

2. Neni 3, paragrafi 3 i Protokollit 1988, është zëvendësuar me tekstin e mëposhtëm:

“3. Çdo Shtet Palë, që ka vendosur juridiksionin e përmendur në paragrafin 2, duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm. Nëse ky Shtet Palë e revokon më vonë atë juridiksion, ai duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm.”.

3. Neni 3, paragrafi 4 i Protokollit 1988, është zëvendësuar me tekstin e mëposhtëm:

“4. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale të përcaktuara në nenin 2, në rastet kur autori i dyshuar është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë në ndonjë nga Shtetet Palë që kanë vendosur juridiksionin e tyre, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.”.

Neni 6

Interpretimi dhe zbatimi

1. Protokollin e vitit 1988 dhe ky Protokoll, si ndërmjet Palëve të këtij Protokollit, duhet të lexohen dhe të interpretohen si një instrument i vetëm.

2. Nenet 1 deri 4 të këtij Protokollit, siç janë rishikuar nga ky Protokoll, bashkë me nenet 8 deri 13 të këtij Protokollit, duhet të caktohen dhe emërtohen “Protokollin për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse” të vendosura në Shelfin Kontinental 2005 (Protokollin për Platformat Fikse SUA, 2005 SUA).

Neni 7

Teksti i mëposhtëm është shtuar në nenin 4bis të Protokollit:

“Klauzolat përfundimtare të Protokollit të Ndalimit të Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental 2005

Klauzolat përfundimtare të Protokollit të Ndalimit të Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental 2005, duhet të jenë nenet 8 deri 13 të Protokollit

të vitit 2005 për Protokollin e Ndalimit së Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Shelfin Kontinental. Referencat e këtij Protokollit të Shteteve Palë duhet t'u referohen Shteteve Palë të Protokollit të vitit 2005.”.

KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll duhet të jetë i hapur për nënshkrim në zyrat qendrore të Organizatës, nga data 14 shkurt 2006 deri më 13 shkurt 2007 dhe duhet të mbetet i hapur për aderim.

2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u lidhur ligjërisht nga ky Protokoll, nga:

- a) Nënshkrimi pa rezervë për ratifikim, pranim apo miratim; ose
- b) Nënshkrimi i subjektit për ratifikim, pranim apo miratim, i pasuar nga ratifikimi, pranimi apo miratimi; ose
- c) Aderimi.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të kryhen me depozitimin e një instrumenti për këtë qëllim te Sekretari i Përgjithshëm.

4. Vetëm një Shtet që ka nënshkruar Protokollin e vitit 1988, pa rezerva, për sa u përket ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose ka ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në Protokollin e vitit 1988, mund të bëhet Palë e këtij Protokollit.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës në të cilën tri shtetet e kanë nënshkruar atë, pa rezerva, për ratifikimin, pranimin ose miratimin, ose kanë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm. Megjithatë, ky Protokoll nuk hyn në fuqi para Protokollit të vitit 2005 të Konventës për Ndalimin e Veprave të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar.

2. Për një Shtet që depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, në lidhje me këtë Protokoll, pas përmbushjes së kushteve në paragrafin 1 për hyrje në fuqi të tij, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit.

Neni 10

Denoncimi

1. Ky Protokoll mund të denoncohet nga çdo Shtet Palë, në çdo kohë, pas datës kur ky Protokoll hyn në fuqi për atë shtet.

2. Denoncimi kryhet me depozitimin e një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Një denoncim do të hyjë në fuqi një vit ose një periudhë më të gjatë, që mund të jetë e përcaktuar në instrumentin e denoncimit, pas depozitimit të instrumentit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 11

Rishikimi dhe ndryshimi

1. Një konferencë, me qëllim rishikimin ose ndryshimin e këtij Protokollit, mund të organizohet nga Organizata.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të thërrasë një konferencë të Shteteve Palë në këtë Protokoll për rishikimin ose ndryshimin e Protokollit, me kërkesën e një të tretës së Shteteve Palë ose pesë Shteteve Palë, cilido që është numri më i lartë.

3. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, i depozituar pas datës së hyrjes në fuqi të një amendamenti të këtij Protokoll, do të konsiderohet të zbatohet si i ndryshuar.

Neni 12

Depozitari

1. Ky Protokoll dhe çdo amendament i miratuar, sipas nenit 11, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm duhet:

a) Të informojë të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose kanë aderuar në këtë Protokoll, për:

i. çdo nënshkrim të ri ose depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, së bashku me datën e tij;

ii. datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll;

iii. depozitim të çdo instrumenti të denoncimit të këtij Protokoll, së bashku me datën në të cilën është marrë dhe datën kur denoncimi hyn në fuqi;

iv. çdo komunikim që kërkohet nga çdo nen i këtij protokoll; dhe

b) Të transmetojë kopje të vërtetuara të këtij Protokoll për të gjitha shtetet që kanë nënshkruar ose aderuar në këtë Protokoll.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij Protokoll, një kopje e vërtetuar e tekstit do të transmetohet nga Sekretari i Përgjithshëm te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, për regjistrim dhe publikim, në pajtim me nenin 102 të ligjit të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 13

Gjuhët

Ky Protokoll është hartuar në një origjinal të vetëm në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëllë autentiq.

Bërë në Londër, në datën katërmëdhjetë tetor dy mijë e pesë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.